



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	29.10.2021
Referenc-ë:	07-353/04-231089/21
Për/ Za/ To:	“Brrring Assistance” SH.P.K
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-231089/21 nga “Brrring Assistance” SH.P.K me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike dhe vendosjen e një tavoline me datë 01.11.2021 nga ora 10:00 deri në 20:00 në sheshin “Zahir Pajaziti”

Qëllimi i kërkesës promovimi i shërbimeve që kryen kompania “Brrring Assistance” SH.P.K.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin “Brrring Assistance” SH.P.K për shfrytëzimin e hapësirës publike dhe vendosjen e një tavoline në sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 01.11.2021 nga ora 10:00 deri në 20:00 për promovimin e shërbimeve që kryen kompania e lartcekur.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.